

VENDIM
Nr. 769, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR OBJEKTIN
“MBROJTJE NGA LUMI I SEMANIT I BREGUT DHE ARGJINATURËS SË KRAHUT TË
MAJTË TË RRJEDHËS NË VENDIN E QUAJTUR GROPA E RRODHES, FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 591, datë 15.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vazhdimin e procedurave të prokurimit për objektin “Mbrojtje nga lumi i Semanit i bregut dhe argjinaturës së krahut të majtë të rrjedhës në vendin e quajtur Gropa e Rrodhes, Fier”, me fondin limit 9 942 232 (nëntë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha